

Të nderuar qytetarë të Komunës së Tetovës dhe komunave përreth të rajonit të Pologut në RM.

Kam nderin në emër të TI-M si edhe në emër të organizatës botërore TI me qendër në Berlin sot ta shpall hapjen e QKNJ të qytetarëve në Tetovë.

Kam nder të vecantë që ditën e parë të punës së Qendrës ta shënojmë me prezencën e Ambasadores së Mbrëtërisë Holandeze në RM, Ekselencen e saj z-njen Mariet Shurman dhe zëvendës Ambasadorin e mbretërisë Holandeze në RM z-ri Peter Verheien.

Qendra në Tetovë do të punojë në kuadër të Qendrës për dhënien e ndihmës juridike qytetarëve të TI në Shkup, me përkrahjen financiare të Ministrisë së Punëve të jashtme të Mbretërisë Holandeze.

Qëllimi kryesorë i TI-M realizohet përmes të ashtuquajturës ALAC (Advocacy and legal advice center) ne ngritjen e vetëdijes për format ekzistuese të korrupsionit dhe ti inkurajoj qytetarët që në mënyrë aktive të kyçen në luftën kundër korrupsionit.

Ate do ta bëjmë përmes bisedës me qytetarët të cilët do ta vizitojnë Qendrën në rr. Vidoë Smileski Bato nr5/2 në Tetovë, përmes komunikimit me qytetarët të cilët do të paraqiten në nr e tel 044/550-300 ose në menyra tjera do të na njoftojnë me problemin që kanë hasur ose janë ballafaquar përmes adrese së postës elektornike alacetovo@transparency.org.mk Qendra në bashkpunim me zyrën në Shkup do të përpunojë analiza juridike kualitative, do të bëjë konsultime, do ti këshillojë qytetarët dhe do të paraqës qendrime, mendime dhe rekomandime deri te institucionet.

Qendra ka për qëllim t'ju ndihmojë qytetarëve në tejkalimin e problemeve me korrupsionin nga jeta e përditshme, të cilat janë të lidhura me punën e institucioneve,

Qendra ka për qëllim ti drejtojë drejt sjelljes së duhur të procedurave dhe të kontaktojë me autoritetet në drejtim të gjetjes së zgjedhjes për luftën kundër korrupsionit

Këtë e bënë I ashtuquajturin I njohur ALAC (Advocacy and legal Advice Center) I vetmi I kësaj natyre.

Përmes tij qytetarët njoftohen dhe I përfitojnë të drejtat e tyre, kurse qasjet proaktive në punë ndikojnë drejtë përforsimit të kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe të autoriteteve lokale.

Ky lloj I Qendrave për këshillë dhe ndihmë juridike ose I njohur si ALAC zbatohet në 44 shtete të botës. Me ALAc TI për herë të parë ua hapi dyertë qytetarëve me dëshirë të ndëgjojë përvojat e tyre me korrupsionin dhe t'ju ndihmojë.

Jam krenare dhe jomodeste kur do te themë se ky project I cili tashmë ka korniza botërore fillloi si ide e imja, këtu në MAqedoni. Ne fillim ishte project 6 mujor në vitin 2002.

Sot qytetarët në gjithë botën përballen me problem nga më të ndryshmet. Korrupsioni në masë të madhe I rrezikon të drejtat e njeriut, duke ju ofruar kushte për pabarazi, diskriminim, proteksionizem.

Në disa pjesë të botës korrupsioni I prek të drejtat themelore të njeriut sic janë uj I shëndetshëm, ushqim, barna.

Shumë shpesh problemet janë në sferën e mbrojtjes shëndetsore, arsimimit, punësimit, e drejta e pronësisë, mashtrimet në procedurat tatimore dhe tenderet, financimin e partive.

Viktimat dhe dëshmitarët e korrupsionit kanë nevojë të negociojnë. TI ju ofron ndihmë dhe këshillë përmes Qendrave të tyre.

TI refuzon të pranojë se njerzit janë apatik të përballen me korrupsionin. Qendrat në mënyrë të suksesshme demonstrojnë se qytetarët mund të kycen në luftën kundër korrupsionit kur ajo ju mundësohet me mekanizma të thjeshta , me zë dhe fleksibile.

Qendrat ju përgjigjen edhe nevojës së përforcimit të individëve në luftën e tyre kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë krijojmë koalicione dhe I kycim qytetarët.

Përvoja jonë nga puna e zyrës në Shkup tregon se nënpunësit e administratës janë shumë të përgatitur të përgjigjen në letrat e derguara nga TI në vend që tu përgjigjen kërkesave të qytetarëve.

Për qëllimet e zyrës TI-M punësoi një jurist të diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës e cila udhëheq me zyrën Z-nja Andrijana Gjorgjevska dhe asistente Z-sha Zana Xhelili.

TI-M dhe Ambasada e Mbretërisë Holandeze nënshkruajti marrëveshje për përkrahjen e Qendrës në periudhë prej dy vjetve. Puna e mëtutjeshme do të mvaret nga ajo sa rezultat do të arrihet, si edhe nga ajo se a do ti shfrytezojnë qytetarët shërbimet e sajë.